



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 289, datë 15/07/2021

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM
TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME MALLAKASTËR

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 15.07.2021 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Konstatoi se:

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër është licencuar me vendimin e KKRR nr. 37 datë 11.07.2019 "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër" për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 330 prot, datë 06.07.2021 me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarifar, shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura".

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Mallakastër është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendorsjes së tarifave.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Mallakastër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër dhe Bashkinë Mallakastër për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani